

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	
---	--	---

Datë/a:	30.09.2022.
Për/ Za/ To:	Operatori Ekonomik: ART HOUSE shpk
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Nexhmi Mekolli – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 29.09.2022 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: ART HOUSE shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me tabela të menqura për institucionet arsimore”**, me Nr. të Prok: **616-22-118-1-1-1** nxjerr:

V E N D I M

1. **REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për ri shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: ART HOUSE shpk e parashtruar me datë: 29.09.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me tabela të menqura për institucionet arsimore”, me Nr. të Prok: 616-22-118-1-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë të AK -së, të datës 25.08.2022 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së , në bazë të nenit 108/A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.**
2. **Autoriteti Kontraktues, mbështet vendimin për të vazhduar lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me tabela të menqura për institucionet arsimore”, me Nr. të Prok: 616-22-118-1-1-1.**
3. **Autoriteti Kontraktues mbështet çdo produkt që ofertoheq që ka specifika më të avancuara sesa përshkrimi i çmimit siç është paraqitur në sqarim të tenderit të datës: 26.09.2022**
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>